



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 988/5 Prot

Tiranë, më 24/9/2020

VENDIM

Nr. 39, datë 24.9.2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 988 Prot., datë 17.08.2020, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet shkresës së datës 20.07.2020, depozituar në adresën elektronike të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik Fhudian.Cuka@turizmi.gov.al, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni, i cili është pjesë e dosjes së Inceneratorit të Elbasanit, konkretisht si më poshtë:

1. Studim fizibiliteti;
2. Paraqitja e tabelës se vlerës përfundimtare të investimit (nr. 11278 prot. dt.27.11.2014);
3. Proces-verbal mbi përfundimin e punimeve në objekt;
4. Urdhër Nr. 81 dt 03.03.2015;
5. Urdhër Nr. 81/1 dt 05.03.2015;
6. Urdhër Nr. 81/2 dt 11.09.2015;
7. Urdhër Nr. 81/3 dt 24.02.2016;
8. Urdhër Nr. 81/4 dt 26.09.2016;
9. Akt Kolaudimi.

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 988 Prot., datë 17.08.2020, pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 988/1 prot., datë 18.08.2020 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit, brenda datës 24.08.2020.

Në tejkalim të afatit të përcaktuar, Autoriteti Publik me shkresën nr. 5731/1 Prot., datë 01.09.2020, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 988/2 Prot., datë 02.09.2020 ka kthyer përgjigje duke informuar ankuesin ndër të tjera se: "... kërkuesi z.

është vënë në dijeni që për procedurën/kontratën e koncensionit me objekt "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Elbasan dhe prodhimin e energjisë", janë duke u zhvilluar procedurat e inspektimit dhe auditimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë. Referuar gërmës "ç", të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", e drejta e informimit në këtë rast kufizohet, pasi dhënia e informacionit shkakton një dëm ndaj interesit të mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike".

Ankuesi, pas refuzimit të dhënies së informacionit nga Autoriteti Publik, ka vijuar ankimin me arsyetimin se: "... Autoriteti Kontraktor (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit) nuk është subjekt inspektimi nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke referuar Vendimin e inspektimit nr. 60, datë 2.6.2020 të këtij të fundit dhe se objekti i inspektimit është kufizuar për periudhën 2018-2019, ndërkohë që kërkesa i referohet dokumentave të 2014-s, 2015-s dhe 2016-s. Gjithashtu, Autoriteti Publik ruan në arkiv një kopje të dosjes koncensionare të Inceneratorit të Elbasanit edhe pse përgjegjësia e kësaj dosje i ka kaluar një tjetër autoriteti publik".

Me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit nr. 119/2014, në të cilin parashikohet se: "...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve", bazuar dhe në nenin 87 të Kodit të Procedurave Administrative, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Komisioneri çmoi të nevojshme zhvillimin e një seance dëgjimore.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 23.09.2020, me prezencën e ankuesit z. nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoriteteve Publike/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, respektivisht nga koordinatorët për të drejtën e informimit.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi dhe përfaqësuesit e Autoriteteve Publike rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri i kërkoi përfaqësuesit të Autoritetit Publik/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për të rivlerësuar qëndrimin e mbajtur, si dhe për t'u shprehur në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 23.09.2020, ka rikonfirmuar qëndrimin si më sipër duke shtuar gjithashtu se: *"Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, që prej fillimit të vitit 2017, i ka transferuar të gjitha dosjet që lidhen me inceneratorët, apo impijantet e trajtimit të mbetjeve, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Rrjedhimisht, dosja e kërkuar dhe gjithë praktika, është transferuar gjithashtu pranë MIE si autoritet kontraktor dhe institucion përgjegjës. Ne, si ministri e disponojmë një kopje të dosjes para transferimit por, gjatë periudhës 2017 - në vazhdim, dosja mund të këtë pësuar ndryshime, shtesa, apo modifikime të tjera brenda kuadrit ligjor dhe ne si ministri nuk e shikojmë të arsyeshme që të japim një dosje/praktike me informacion jo të saktë dhe që është fushë e përgjegjësisë së një ministrie tjetër".*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Në lidhje me argumentin e parashtruar nga Autoriteti Publik, sipas së cilit: *"...pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë duke u zhvilluar procedurat e inspektimit dhe auditimit nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Referuar gërmës "ç", të pikës 2, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", e drejta e informimit në këtë rast kufizohet, pasi dhënia e informacionit shkakton një dëm ndaj interesit të mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit të autoriteteve publike", Zyra e Komisionerit vlerëson se, Autoritetit Publik, nuk ka arsyetuar në lidhje me vlerësimin e parimit të proporcionalitetit, si dhe dëmin e qartë dhe të rëndë në interesin e mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit që mund të vinte si pasojë e dhënies së informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar.*

Pika 2 e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" parashikon se: *"e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë".*

Ky parashikim nuk mund të aplikohet apriori nga ana e Autoritetit Publik, por duhet të analizohet dhe të argumentohet nëse nxjerrja e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar do të shkaktonte një dëm serioz, të qartë dhe të rëndë për mbarëvajtjen e procedurave të inspektimit dhe auditimit. Autoriteti Publik ka detyrimin në çdo rast të

provojë dëmin e qenësishëm dhe të vlerësojë proporcionalitetin e këtij dëmi në raport me të drejtën e publikut për të patur dijeni.

Lidhur me refuzimin e dokumentacionit duke cituar se: *"... ne si ministri e disponojmë një kopje të dosjes para transferimit por, gjatë periudhës 2017 - në vazhdim, dosja mund të ketë pësuar ndryshime, shtesa, apo modifikime të tjera brenda kuadrit ligjor..."*, Zyra e Komisionerit vlerëson se, argumenti i dhënë nuk është i bazuar në ligj.

Autoriteti Publik detyrohet të vendosë në dispozicion të kërkuarit informacionin/dokumentacionin e kërkuar në gjendjen që e disponon, pa bërë vlerësim të saktësisë apo dobishmërisë së këtij informacioni/dokumentacioni.

Në këto rrethana, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit"*.

Komisioneri vlerëson se, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, gjatë vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim"*.

Ndërkohë në pikën 1, të nenit 18 të ligjit për të drejtën e informimit, parashikohet se mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji, passjell përgjegjësi administrative. Në pikën 2, të nenit 18 parashikohet se veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë vepër penale konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë.

Bazuar në sa më sipër, mosveprimi në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe detyrimin sipas këtij vendimi, passjell vendosjen e penaliteteve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 18, ndaj personave përgjegjës.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur

ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Autoritetit Publik/Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 988 Prot., datë 17.08.2020 të z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/ dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 20.07.2020, brenda datës 02.10.2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 24.9.2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

